



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1064/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Shkëlzen Osmani, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Vushtrri, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1064/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë Shkëlzen Osmani, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Vushtrri, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në Komunën e Vushtrrisë

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë Shkëlzen Osmani, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Vushtrri, në të cilën thekson se gjatë numrit të formularëve të rezultateve kandidati Basri Menxhiqi ka 245 vota kurse në rezultatet e publikuara ka 254 vota. Parashtruesi i apelit dyshon se ka gabim të zyrtarëve të numërimit ku në vend të numrit 245 figuron 254, andaj i njëjti kërkon verifikimin e formularëve të kandidatëve për asamble nga qyteti i Vushtrrisë.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar ndonjë provë bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur ndonjë parregullsi për kandidatin në fjalë, për faktin se thëniet e tij janë vetëm supozime dhe sipërfaqësore dhe jo të konkretizuara me asnjë provë konkrete bindëse për të cilën ai pretendon lidhur me parregullsitë në rezultate.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Shkëlzen Osmani nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Vushtrri, nuk është i bazuar me asnjë provë apo dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë parregullsi në vota në formularë e rezultateve të publikuara.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1064/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuese e Panelit
Milena Đerić



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.